



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të Komisionit për periudhën 27 Shkurt – 20 mars 2015.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruar nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksioneve të BERZH-it, për planin e qëndrueshëm të transportit në Shqipëri”
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjeve të grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant, të siguruar nga BERZHI-i, nga burimet e veta, nën fondin e veçantë të aksioneve, për strategjinë e taksimit rrugor në Shqipëri”
4. Projektligji “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Arben Ristani, Eduart Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili, Mhill Fufi.

Të ftuar:

Deputetet: Majlinda Bregu, Taulant Balla, Kejdi Mehmetaj

Elona Mestrovica – Sektori i Huamarrjes në Ministrinë e Financave

Argita Totozani – drejtore në Drejtorinë e Integrimit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj - Fillimisht është miratimi i draft-kalendarit të komisionit për periudhën 27 shkurt – 20 mars, mbështetur në programin dhe në kalendarin e Kuvendit.

Ky është pak a shumë një draft, dhe besoj se është thjesht për t'u orientuar komisioni, jo se është rënë dakord.

Kishit ndonjë merak për këtë?

Atëherë, siç është rënë dakord, paraprkishtë, bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetarëve, dëshiroj që të jem maksimalisht korrekt, që të mos lëmë ndonjë gjë evazive.

Lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë do të ketë dy relatorë, që do të punojnë bashkërisht, zoti Subashi dhe zoti Bylykbashi, për të arritur në një draft të përbashkët lidhur me shqyrtimin e propozimeve të sjella nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe propozimin e tre kolegeve deputete për përfshirjen e disa amendamenteve në Kodin Zgjedhor.

Me t'u bërë gati ky projekt, do të shqyrtohet në komision. Dakord?

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës. Meqenëse ne kishim parashikuar si pikë të katërt shqyrtimin e projektligjit “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, dhe zonja Bregu është një nga tre kolegët iniciues të kësaj nisme, ka një angazhim tjetër në komisionin që drejtohet prej saj, gjykojmë të arsyeshme për ta kaluar pikë të dytë të rendit të ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, për procedurë, zoti Ristani, urdhëroni!

Arben Ristani – Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë,

Ne jemi dhe Komisioni i të Drejtave të Njeriut, dhe unë do t'ju kërkoja që ne ta diskutojmë dhe të përcaktojmë se çfarë hapa duhet të ndërmarrim, sepse, siç e dini, dje, ka ndodhur një ngjarje shumë e rëndë, ka pasur një grevë të studentëve të Mjekësisë apo të Infermierisë, të cilëve u është ndërprerë greva natën duke gdhirë dita e re, nga forcat e policisë,

me dhunë. Ju e dini që studentët kanë pasur pretendimet e tyre, të drejtën e tyre për të bërë një grevë, kanë kërkuar si edhe shokët e tyre që për shërbim të njëjtë të paguajnë tarifë të njëjtë, por gjithsesi, kërkesat e grevës është problemi i tyre, çështja jonë është që greva është një e drejtë e tyre për të ushtruar të drejtën e tyre, për të mbrojtur të drejtën e tyre, jemi shoqëri demokratike që duhet t'i trajtojmë me kujdes, me dashamirësi për sa kohë janë dhe të rinjtë e këtij vendi, që meritojnë një trajtim prej dashamirësi, në mos prej prindi.

Dhe ajo që ka ndodhur është një ndërhyrje tërësisht brutale, siç i pamë dhe pamjet filmike, janë marrë me dhunë, janë lidhur këmbë e duar si bagëti, janë transportuar me makina private dhe pa targa, janë çuar në vende të paditura, hiq në një rajon dhe dërgo në një tjetër, janë gjakosur, kanë përfunduar në spital një numër i madh prej tyre, dhe kjo është një gjë shumë shumë e rëndë, të cilën unë mendoj që ky komision ka për detyrë ta trajtojë dhe të gjejë rrugët dhe format se si mundet që situata të tilla t'i parandalojmë dhe përgjegjësit t'i vëmë përpara përgjegjësisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Zoti Ristani, kjo nuk është një gjë procedurale, por është një deklaratë politike, është përtej rregullave të një procedure të zakonshme parlamentare, gjithsesi unë nuk dëshiroj ta fus komisionin pa rend dite dhe pa procedurë në një debat që është jashtë rregullave parlamentare. Do t'ju sugjeroja që konform rregullave që ka Kuvendi për funksionimin e komisioneve, nënkomisioneve dhe seancës plenare, të ndiqen procedurat, dhe nëse ka nevojë për të bërë një debat për këtë gjë, të respektohen të gjitha instrumentet për të bërë një debat.

Ju, për procedurën e komisionit.

Oerd Bylykbashi - Kolegu sapo ngriti një shqetësim. Ne jemi komisioni përgjegjës për të drejtat e njeriut. Kemi një nënkomision për të drejtat e njeriut dhe ajo që me shumë racionalitet zoti Ristani ngriti, është që ky komision duhet ta bëjë objekt të diskutimit të tij nëpërmjet instrumenteve të këtij nënkomisioni, i cili duhet të reagojë ndër të parët për ta shqyrtuar çështjen. Kjo nuk është çështje politike, por është çështje e dhunimit të Kushtetutës, të të drejtave individuale të atyre studentëve dhe të drejtës së tyre në grup për të kryer një grevë. Është dhunuar ajo, pse ngrenë ata problemet, cila është arsyeja, nuk na përket neve. Ne duhet që nëpërmjet këtij komisioni të marrim dhe të shqyrtojmë situatën dhe të gjejmë rrugët që këto gjëra të mos përsëriten më. Pastaj se çfarë nuk e propozuam ne tani...

Fatmir Xhafaj - Propozoni sipas procedurës, kjo nuk është mbledhje partie. Ky është komisioni i Kuvendit të Shqipërisë, që funksionon sipas rregullave. Bëhet një deklaram që, në vlerësimin tim, kishte një ngjyrim politik. Kërkoni ta vini në lëvizje. Ka një rregull. Duhet ta kërkosht sipas procedurës. Procedoni me nënkomisionin për të drejtat e njeriut, kërkoni procedurën dhe vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Siç ju thashë, është shqyrtimi i projektligjit “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” iniciativë e ndërmarrë nga tre kolegë deputetë, të tri grupeve parlamentare, zonja Bregu, zoti Balla, dhe zonja Mehmetaj.

Zonja Bregu është e pranishme.

Faleminderit, zonja Bregu, që jeni këtu, në këtë mbledhje komisioni!

Një ekspozitë të shkurtër të iniciativës.

Majlinda Bregu – Faleminderit për ftesën dhe faleminderit për gatishmërinë për të shqyrtuar këtë ligj, pavarësisht se është kërkuar me procedurë të përshpejtuar!

Ligji “Për forcimin e rolit të Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian” është një iniciativë ligjore e depozituar më saktë si iniciativë ligjore e tre deputetëve, nga një përfaqësues i grupeve parlamentare në Kuvend ndërmjet majorancës dhe opozitës. Pavarësisht se nisi si iniciativë në të cilën ishte përfshirë edhe zonja Tabaku, në përfundim, në dakordësi me Komisionin e Integritit dhe me punën e juristëve të Kuvendit me opinionin dhe komentet e shoqërisë civile, ka mbërritur në këtë fazë në të cilën paraqitet për miratim.

Besoj se me këtë ligj i jemi shmangur ose më saktë kemi sjellë një risi duke e larguar procesin e kontrollit parlamentar në rrugën tonë të integritit nga deklaratat dhe nga tonet deklarative, në forcimin e llogaridhënies më të madhe të qeverisë ndaj parlamentit për procesin e integritit, duke i dhënë parlamentit një rol më aktiv në këtë proces përfshirë këtu edhe shoqërinë civile dhe mediat e pavarura.

Kemi hyrë në një fazë të re të marrëdhënieve tona me BE-në. Detyrimet të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit e bëjnë të domosdoshëm një kuadër më të plotë ligjor për rolin e parlamentit në proces, por faza tjetër më e rëndësishme është ajo e pas marrjes së statusit të vendit kandidat me pesë detyrimet dhe prioritetet që Shqipëria ka detyrim për të zbatuar.

Besoj se do të ketë punë më shumë edhe për ju, Komisionin e Ligjeve, pasi të pesë prioritetet, të cilat zbërthehen në reforma konkrete dhe sikurse unë besoj, edhe ju pak keni dëgjuar të flitet në këto kohë se sa janë realizuar dhe sa janë plotësuar, do të keni mundësinë, tashmë, për këdo që do të ketë dëshirë edhe profesionale brenda funksionit të deputetit dhe kërkim llogaridhënies ndaj qeverisë, dhe jo vetëm politike sigurisht, për të kërkuar informacion rreth zbatimit të këtyre detyrimeve.

Besoj se edhe kolegët e mi, përveçse për procedurën tuaj në komision, edhe shqetësimin që ngritën për çështjen e të drejtave të njeriut e lidhin me detyrimin madhor që ka Shqipëria, është pjesë e prioritetit nr. 5, nuk besoj se do të ketë shmangie për të raportuar për zbatimin apo për dhunimin e të drejtave të njeriut, për sa kohë ne jemi të detyrimet për t'i raportuar Komisionit Europian dhe institucioneve evropiane, gjithçka çfarë ndodh dhe, nëse zbatohen apo jo detyrimet edhe në këtë pikë.

Në këtë ligj përcaktohen për herë të parë detyrimet institucionale, të cilat nuk kanë qenë të mirëpërcaktuara në ligjin e vjetër, në rolin e institucioneve të cilat sot janë pjesë e procesit, por nga ana tjetër përcaktohet edhe ngritje e një organizmi të ri, i cili do të ngrihet brenda parlamentit, ngritja e Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, i cili do të jetë i përbërë nga deputetë, përfaqësues të shoqërisë civile, nga përfaqësues të medias, nga përfaqësues të zyrës së Kryeministrit dhe të zyrës së Presidentit dhe që sigurisht do të jetë organi më i lartë konsultativ për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.

Një risi tjetër, e këtij ligji të cilën deri më sot nuk e kam parë të ndodhë në parlamentin e Shqipërisë, është detyrimi që fillon që nga Kryeministri, ministri i Integritetit dhe ministrat e tjerë për të raportuar brenda një kohe të caktuar në Kuvend, për të diskutuar dhe për të raportuar për planin vjetor për legjislacionin dhe miratimin e tij, por edhe për procesin e integritetit në përgjithësi dhe detyrimet të cilat, e përsëris, kanë munguar edhe në këtë vit që kaluam në parlament, ku ministri i Integritetit duhet të raportojë në bazë të dorëzimit të dokumentit më të rëndësishëm të Komisionit Europian, që është progresraporti për plotësimin e detyrimeve, por edhe për detyrat që progresraporti parashtron përpara qeverisë dhe Kuvendit.

Këto janë propozimet dhe risitë që sjell ky projektligj, i cili do të plotësojë edhe mangësitë procedurale të ligjit aktual, i cili ka qenë deri tani në fuqi.

Nga ana tjetër, do të përcaktojë në një mënyrë më të mirë detyrimet që ka qeveria për të raportuar në parlament dhe do të rrisë rolin e kontrollit parlamentar ndaj qeverisë në zbatimin e

detyrimeve, të cilat nuk mund të jenë vetëm retorikë dhe deklarata politike, por kanë afate konkrete dhe janë lehtësisht të verifikueshme, si respektimi i detyrimeve, apo mosrespektimi, apo rrëshqitja nga standardet evropiane.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Unë do të doja të falënderoja firmëtarët e kësaj iniciative, por njëkohësisht do të doja të bëja me dije se ky projektligj është shumë i rëndësishëm që edhe shumë vende të tjera, që kanë qenë në procesin e integrimit evropian ose përgatiten për integrimin e vendit në BE, e kanë ndërmarrë.

Njëkohësisht do të doja të bëja me dije se deri më sot ka pasur një ligj dhe është konkretisht ligji i vitit 2004 i zotit Zela, për punën e Kuvendit në procesin e integrimit evropian të Shqipërisë, por po ta analizojmë sot, pra pas 11 vjetësh, ky ligj nuk u përgjigjet nevojave që ka Kuvendi për të shprehur rolin e rëndësishëm që duhet të luajë në procesin e integrimit të Shqipërisë në BE.

Nga ana tjetër, është një ligj me procedurë të përshpejtuar që po shqyrtohet dhe më lejoni të falënderoj edhe kryetarin e e komisionit që e renditi në ligjet e para.

Në fakt, relacioni i përgatitur që shoqëron projektligjin është i plotë. Ai vë në pah risitë që sjell projektligji. Unë do të doja të evidentoja momentet më të rëndësishme dhe që janë të domosdoshme për diskutimin e këtij projektligji nen për nen.

Në radhë të parë përcaktohen kompetencat apo përgjegjësitë që ka jo vetëm Kuvendi, por edhe Këshilli i Ministrave në kuadër të integrimit evropian.

Së dyti, krahas komisionit krijohet Komiteti Parlamentar për Stabilizim- Asociimin që tashmë ekziston si komision i veçantë dhe është organ këshillimor.

Gjithashtu, rregullohen marrëdhëniet midis qeverisë dhe Kuvendit në procesin e integrimit evropian.

Deri më sot nuk është se Kuvendi nuk ka luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në proceset e integrimit, por këto u janë lënë komisioneve të përhershme parlamentare sipas axhendës së tyre.

Ndërsa me këtë projektligj përcaktohen jo vetëm rregullat specifike për detyrimet që ka Këshilli i Ministrave ose ministria e Integritimit, por njëkohësisht përcaktohen edhe afatet lidhur me raportimin dhe detyrimet që ka Kuvendi në lidhje me këto raportime.

Gjithashtu, një risi që është për t'u vlerësuar në këtë nismë është që atë rol që ka luajtur Komisioni i Ligjeve, por edhe Komisioni i Integritimit në shqyrtimin e progresraportit të Komisionit Europian, tashmë me ligjin e ri Këshilli i Ministrave detyrohet të raportojë në Kuvend për gjetjet, rekomandimet dhe situatën e zhvillimeve politike-ekonomike dhe njëkohësisht detyrohet Kuvendi që të diskutojë, të ketë një debat dhe të miratojë një rezolutë përkatëse.

Ky projektligj sanksionon edhe një herë atë lloj fryme bashkëpunimi që ne në komision e kemi pasur me shoqërinë civile, medien dhe grupet e interesit, sepse tashmë sanksionohet bashkëpunimi i shoqërisë civile dhe i publikut për miratimin dhe zbatimin e politikave të kuadrit normativ në kuadër të integritimit evropian.

Sikurse e tha kolegja Bregu, ka nisma edhe në vendet e tjera. Unë kam studiuar modelin kroat, modelin hungarez, apo edhe të vendeve të tjera si Maqedonia Bullgaria, ndërkohë që do të doja që gjatë diskutimit nen për nen të bëja edhe disa pyetje, sugjerime apo amendime.

Në tërësi, do të thosha, se në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën; në aspektin procedural i plotëson kushtet që duhet të ketë një nismë që paraqitet para një komisioni të përhershëm të Kuvendit, pasi të bëjmë edhe diskutimin nen për nen, ju ftoj për ta miratuar atë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Mediu.

Fatmir Mediu – Duke vlerësuar nismën, unë kam një pyetje për sa i përket Këshillit Kombëtar të Integritimit. Shikoj që janë përcaktuar përfaqësues nga shoqëria civile. Po të jenë përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile të përfshira në çështje të integritimit evropian, nuk ka ndonjë organizëm që të mos jetë përfshirë, të gjitha janë të përfshira në çështjet e integritimit evropian, a ka mundësi të jemi më specifik, sepse atëherë do të dalim në organizma të cilat bëhen jofunksionale, ose të paktën duhet të ketë një kuptim të përbashkët të palëve që janë në proces, pozitë-opozitë, për përfaqësuesit që duhet të jenë në Këshill. E para.

E dyta, janë gjitha këto struktura që marrin pjesë, pa dyshim edhe parlamenti, por për sa kohë flasim për vullnet politik të përbashkët, mendoj se duhet të jenë të përfshirë në strukturën e Këshillit European të Integritit European edhe përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose kryetarët e grupeve parlamentare, përcaktojeni si ta gjykoni të arsyeshme, sepse nuk është procesi i dy palëve që përfaqësohen por është procesi i të gjithë parlamentit.

Fatmir Xhafaj – Kush do të përgjigjet për pyetjen e zotit Mediu. Po, zoti Balla.

Taulant Balla– Po filloj nga pyetja e dytë, pastaj do t'i përgjigjem pyetjes së parë. Parimisht, grupet parlamentare janë të përfaqësuar, po të kemi parasysh që janë 8 komisione parlamentare, në të cilat 5 janë grupe parlamentare të maxhorancës dhe tre të opozitës, megjithatë për ne nuk ka asnjë problem nëse do të përfshiheshin edhe kryetarët e grupeve parlamentare, si propozim i sjellë nga zoti Mediu, por të them të drejtën nuk është se do të shtonte diçka fakti që do të jenë edhe kryetarët e grupeve parlamentare pjesë e këtij Këshilli, po të kemi parasysh që grupet janë të përfaqësuara.

Në fund të fundit, edhe përfaqësimi i drejtimit nga formulimi që është bërë, dihet që kryetari i Këshillit është përfaqësues i opozitës, zëvendëskryetari është përfaqësues i maxhorancës, në çdo lloj konteksti, jo vetëm në kontekstin e sotëm të parlamentit, por edhe në kontekstet e ardhshme, po të kemi parasysh edhe standardin e vendosur tashmë prej vitit 2004 që kryetari i Komisionit të Integritit është gjithmonë përfaqësues i opozitës. Megjithatë, si dy bashkëpropozues të këtij projektligji, nuk do të kishim asgjë kundër, nëse do të insistohet që kryetarët e grupeve parlamentare të ishin pjesë e saj.

Për sa i përket çështjes së përkufizimit të organizatave të shoqërisë civile, ne, në radhë të parë, i jemi përmbajtur formulimit të ligjit kroat për këtë çështje, të cilin e kemi marrë si referencë dhe në ligjin kroat është specifikisht “organizata të shoqërisë civile të përfshira në çështje të integritit evropian”. Vihet re tërësisht dakord që çdo lloj shoqate ka orientimin e saj, por siç ka edhe raste shoqatash, të cilat nuk promovojnë çështje që lidhen me integritimin evropian. Kështu që përkufizimi i çështjeve e ka specifikuar rastin e shoqatave që promovojnë vlerat dhe çështjet e procesit të integritit evropian. Sigurisht ky do të jetë një proces i hapur. Mbledhjet e këtij këshilli janë të hapura çdo përfaqësues i shoqërisë civile është prezent.

Unë do t'ju bëj me dije se ndryshimi që sjellim ka për objektiv përfshirjen e të gjithë aktorëve socialë, ekonomikë në procesin konsultativ që kryen ky Këshill, domethënë një kritikë e kahershme e progresraporteve, që për sa i përket procesit ligjvënës, dhe këtu kemi të bëjmë

plotësisht me procesin ligjvënës dhe kontrollues të Kuvendit, ka një mungesë të theksuar të konsultimit me grupet e shoqërisë civile. Unë besoj se me ndryshimet e sjella kjo lloj kritike e BE-së merr fund për atë kohë se shoqëria civile do të jetë e përfshirë.

Më lejoni t'ju informoj, gjithashtu, besoj se kryetarja e Komisionit të Integritetit e ka bërë që në fillim, që edhe në procesin e draftimit të ndryshimeve në këtë projektligj, procesi filloi nga shoqëria civile, pra ishte shoqëria civile shqiptare, e cila solli propozimet e para për ndryshimin e ligjit dhe më pas u kalua në procesin e draftimit nga ana e ekspertëve të Kuvendit dhe jo vetëm.

Ky ligj, sikurse u tha, është një ligj prej 11 vjetësh. Në këto 11 vjet, në pjesën më të madhe të kohës nuk është respektuar asnjë gërmë e tij, kështu që duhet të bëjmë dakord, që me të kaluar ndryshimet e këtij ligji, prerogativat e tij të jenë të respektueshme, sepse vetëm kështu rrisim rolin që ka Kuvendi i Shqipërisë si rol primar në procesin e integritetit të vendit.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë kam një pyetje të drejtpërdrejtë. Këtu thuhet: “Këshilli Kombëtar i Integritetit drejtohet nga kryetari i Komisionit të Integritetit”. Unë kam shumë respekt për zonjën Bregu, nuk ka të bëjë fare me zonjën Bregu, as me zotin Balla që është nënkryetar i delegacionit, ku është gjetur kjo formë që ky Këshill Kombëtar që ne krijojmë me ligj e drejton një kryetar komisioni, ndërkohë që në përbërjen e këtij Këshilli Kombëtar, ka të gjithë këto personalitete? Mos duhet vallë të kishim ndonjë personalitet të jashtëm që të drejtonte Këshillin Kombëtar që të mos kemi paralelizma me Komisionin e Integritetit? Thjesht e kam për kulturën time, nuk e kam me ju të dy.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Kush do të përgjigjet?

Po, zonja Bregu.

Majlinda Bregu – Faleminderit!

Zoti Fino, edhe ne nuk kemi asnjë dyshim se ju ndiheni shumë komodë që ta drejtojmë ne të dy, pavarësisht se cilat mund të jenë, le të themi, propozimet e tjera në rast se do të keni. Këshilli Kombëtar i Integritetit i paraqitur, do të specifikohet më pas në një rregullore, e cila do të miratohet nga Byroja e Kuvendit, për të përcaktuar qartë të gjitha detyrimet dhe funksionet e këtij këshilli. Është një model i aplikuar në vende të cilat kanë qenë përpara Shqipërisë në këtë proces. Konkretisht, ky është modeli i Kroacisë, i cili është vendi i fundit i anëtarësuar në

Bashkimit European. Në këtë format, ndoshta me emërtime të tjera, diku këshill, diku dialog kombëtar, diku këshill kombëtar, ka ekzistuar edhe në vende të tjera, përfshirë Letoninë, Sllovakinë, në momentin kur ka qenë në këtë fazë të procesit.

I lihet drejtimi opozitës dhe kryetarit të Komisionit të Integritetit, me një arsyetim të thjeshtë: Komisioni i Integritetit është ai, i cili do të shqyrtojë legjislacionin dhe propozimin ligjor, i cili sot ka një risi tjetër, sepse Komisioni i Integritetit mendimin me shkrim përpara se të miratohet një ligj i ri, i cili ka lidhje dhe ka përafrim me acqui-në e Bashkimit European, për çdo komision tjetër, përfshirë Komisionin e Ligjeve. Pra, ky është arsyetimi, sepse është, le të themi, Komisioni i Integritetit është niveli më i lartë parlamentar, i cili trajton, prek, ndjek në detaje të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integritetin dhe me legjislacionin.

Për sa kohë kryetari i Komisionit të Integritetit, sikurse e tha zoti Balla, gjatë gjithë traditës së këtyre viteve, i është lënë opozitës apo drejtohet Komisioni i Integritetit nga opozita, për të forcuar e siguruar edhe me anë të këtij këshilli mekanizmin konsultativ, por edhe atë të kontrollit parlamentar, që kryhet normalisht nga opozita, ky pozicion i lihet, le të themi kryetarit të Komisionit të Integritetit, dhe sigurisht opozitës.

Në rastin e Kroacisë, të cilin jua përmenda, i tillë ka qenë formati: kryetarja e Komisionit të Integritetit ka qenë kryetare e Këshillit Kombëtar, sot është Ministre e jashtme. Kështu edhe me eksperiencat e vendeve të tjera.

Të lutem, para se ta mbyll, zoti Mediu ngriti shqetësimin për shoqërinë civile. Edhe ne e kemi pasur këtë shqetësim, se cilët do të jenë përfaqësuesit e shoqërisë civile, qoftë edhe për të mos krijuar një debat, për të cilin nuk kemi nevojë, por ju siguroj se ftesa iu është çuar edhe në hartimin e këtij ligji të gjithë spektrit të shoqërisë civile, le të themi, ne do të mundohemi që të përzgjedhim në dakordësi me ta, përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë qenë aktivë edhe në dhënien e mendimit, edhe në dhënien e kontributit, e të cilët gjatë gjithë kësaj kohe kanë qenë pjesë në këtë proces.

Më pas, në orën 11, kemi një takim me shoqërinë civile, ku kjo do të jetë një nga çështjet e para që diskutohet. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Diskutime? Po, zoti Mediu. Pastaj zoti Halimi!

Fatmir Mediu – Atëherë, në vazhdimësi të pyetjeve që ngrita, mendoj, se duhet pasur shumë kujdes në ndërtimin e këtij këshilli, për sa i përket përbërjes së tij, si nga shoqëria civile, ashtu dhe nga politika, për faktin se mendoj që ka specifika brenda organizimeve të shoqërisë civile, të cilat përqasen me interesat që kanë të bëjnë me procesin e bashkimit Europian, të cilat nuk mund të shfaqet ndonjëherë me idenë e madhe thjesht politike të shoqërisë civile që merren me BE-në, por që janë specifikisht në fusha të ndryshme, që kanë të bëjnë qoftë me përqasjen e legjislacionit, qoftë me shqetësime që vijnë nga ana e Bashkimit Europian, do të ishte mirë të mbajmë atë pjesë të shoqërisë civile, e cila është vërtet aktive, siç thoni ju, për çështjen e integritetit evropian, dhe e kanë këtë si interes të vetin e padyshim të shikojmë ata që e kanë si interes politik të vetin, përfitimi politik të vetin.

Nuk është vetëm rasti i Shqipërisë, është edhe rasti i vendeve të ndryshme ku kanë ndodhur gjëra të tilla. Për sa i përket pjesët së dytë, që u përpoq ta sqaronte edhe zoti Balla, po e sqaroj edhe një herë. Ky është një proces që përfshin të gjitha forcat politike në parlament. Duke qenë një proces që përfshin të gjitha forcat politike në parlament, pa dyshim që ka nevojë për përfaqësimin e të gjitha forcave politike të parlamentit. Ndarja në komisione nuk ka detyrimisht të njëjtën ndarje politike që ka parlamenti, nga pikëpamja e drejtimit të tyre, prandaj do të ishte shumë mirë të kishte ose përfaqësues grupesh ose kryetarë të grupeve parlamentare.

Për sa i përket funksionimit ose jo të ligjit – vetëm për t’jua kujtuar – ky ligj vërtetë ka rreth njëmbëdhjetë vjet që është përcaktuar më parë, por kjo marrëdhënie ka qenë një marrëdhënie që në komisionin ad hoc të integritetit evropian, për marrëdhëniet me qeverinë dhe shoqërinë civile, dhe ka qenë funksionale për atë kohë, brenda atij gjykimi, aq sa ka qenë e mundur. Dhe po ju them: ka qenë disa herë, në raport edhe me ish-Kryeministrin, në atë kohë, në atë komision; ka qenë më tepër i respektuar, po ju them, nga pikëpamja e marrëdhënieve ekzekutiv-parlament, nga ç’mund të ketë qenë në këtë kohë. Ka qenë më i përgjegjshëm ekzekutivi, marrëdhëniet me parlamentin, për të raportuar për të gjithë procesin, ashtu siç ka qenë më aktive edhe shoqëria civile, në mënyrë të organizuar në këtë këshill apo në marrëdhënie me integritetin evropian.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Do të bësh komente?

Taulant Balla – Një koment të shkurtër. Ne do të kërkonim që në relacionin e Komisionit të Ligjeve, të biem dakord për formulimin që, pas pikës...

Fatmir Xhafaj – Zoti Balla, kur të vemi te nen për nen. Na fal!

Taulant Balla – Ah, dakord!

Fatmir Xhafaj – Ju do të jeni me siguri këtu, se shqyrtimin nen për nen me ju do ta bëjmë. Po s’e bëmë, do ta ndërpresim ne pastaj.

(Diskutime pa mikrofon)

Secili komision ka të drejtën e kalendarit të tij. Ne s’kemi të drejtë të diskutojmë kalendarin e atij komisioni.

(Diskutime pa mikrofon)

Po ju keni të drejtë, se këtu ngatërrohen nganjëherë mollët me qepët.

Zoti Halimi, fjala për ju

Eduard Halimi – Zoti kryetar!

Të nderuar kolegë!

Sa herë që vjen puna te çështjet e integritetit, sigurisht opozita është treguar dhe do të tregohet konstruktive, sepse jemi të bindur që qytetarët shqiptarë nuk janë lodhur, siç është lodhur Kryeministri në rrugën drejt integritetit të vendit në Bashkimit Europian, pasi ata kërkojnë që vendi t’i ngjajë çdo ditë e më tepër një vendi të Bashkimit Europian. Por kjo nuk arrihet me ligje – gjykoj unë – si ky që na vjen sot këtu, por arrihet me plotësim standardesh, arrihet me plotësim kriteresh.

Një ligj, thotë njëri nga kolegët, i cili ka 11 vjet që paska qenë në parlament, që nuk është aplikuar, por që Shqipëria ka merituar statusin e vendit kandidat. Dhe e ka merituar këtë status, sepse plotësoi kushtet, plotësoi standardet për të marrë statusin. Kemi një vit e gjysmë që qeveria nuk flet për integritetin e vendit, nuk flet as për reformat që duhen në plotësimin e kushteve e të standardeve. Kur flasim për standarde dhe kur flasim për bashkëpunim me opozitën, do të thotë tolerancë nga qeveria e maxhoranca, dhe konstruktivitet nga opozita. Ajo që ka ndodhur e që po ndodh këtu, gjë për të cilën edhe ky komision këtu është përgjegjës, ka të bëjë me plotësimin e standardeve themelore se si sillet parlamenti dhe palët politike në plotësimin e kushteve e standardeve.

Mënyra se si sillet parlamenti dhe ky komision, është shumë larg standardeve të Bashkimit Europian. Ky komision dhe parlamenti ka demonstruar gjatë këtyre muajve, mbas marrjes së statusit të vendit kandidat. Një sjellje anti-europiane, antiparlamentare, jotolerante, por arrogante, në lidhje me çështjet kryesore, që kanë të bëjnë me integritetin evropian, çështje të

cilat shqetësojnë qytetarët shqiptarë, çështje të cilat kanë të bëjnë me reformat kyçe, me pse prioritetet e integritetit në Bashkimin Europian. Flasim për reformën në drejtësi. Flasim për ligjet, të cilat kanë kaluar në fushën e drejtësisë, që i ka kaluar ky komision, me një skemë e cila nuk ka të bëjë me standardet evropiane, por ka të bëjë me një sjellje arrogante të qeverisë e maxhorancës, sjellje e cila nuk mund të mirëpritet nga Bashkimi Europian, dhe sigurisht s'mund të mirëpritet as nga opozita.

Por, çfarë ka ndodhur këtu? Cilat janë standardet e Bashkimit Europian? Më thoni një vend të Bashkimit Europian, ku policia sillet si bandë gangsterësh dhe ndërpret me dhunë, në mes të natës, në orën 2 të natës, grevën e ligjshme të 40 studentëve të infermierisë. Ju këtu, i pari, zoti kryetar, mbasi u ngrit shqetësimi nga kolegët e mi, duhet ta kishit ngritur edhe ju shqetësimin, ta kishit futur në kalendar, sepse këto janë çështje që i shqetësojnë qytetarët shqiptarë, janë çështje të integritetit, janë çështje të lirive themelore e të drejtave të njeriut. Më thoni, thashë, një vend të Bashkimit Europian, ku policia sillet si bandë gangsterësh, merr e lidh 40 studentë në mes të natës dhe i shoqëron me makina private.

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, do t'ju lutesha që të mos deklaroni shprehje fyese për Policinë e Shtetit. Nuk është serioze në këtë komision. Gjithsesi, është e drejta juaj.

Eduard Halimi – Juve vetë keni qenë protagonist gjatë tetë viteve të opozitës, të një sërë grevash. Ju kemi respektuar dhe ju respektojmë. Keni qenë këtu ju, bashkë me disa kolegë, njëzet e një ditë, pesë metra larg këtu, në mes të bulevardit. Nuk preku kush asnjëri. Policia e Shtetit nuk preku kurrë asnjëri. Më thoni ju mua: në njëzet e pesë vjet, kush ka guxuar të urdhërojë policinë e shtetit, që në orën 2 të natës të lidhë me këmbë e duar 40 studentë, djem, të rinj e të reja, dhe t'i shoqërojë në ambientet e policisë, duke i plagosur, rrahur e duke u sjellë me ta si kafshë? Këto janë çështje që duhet të shqetësojnë parlamentin. Më thoni ju mua një vend të Bashkimit Europian, që të arrestojë 38 mijë qytetarë brenda një viti, të mbajë 20 vetë në një qeli, të arrestojë fëmijë të mitur në 5 vjeç, njerëz të cilët janë të pamundur për të paguar energjinë, njerëz të cilët janë të pamundur për të paguar gjrobat dhe haraçin e qeverisë, që vjen nga kamatëvonesat, se është haraç ai.

Në cilin vend të Bashkimit Europian qeveria çon qytetarët drejt vetëvrasjes, vetëm pse e kanë të pamundur për të paguar energjinë apo haraçin e qeverisë?

Në cilin vend të Bashkimit Europian, qeveria shemb, duke u sjellë si bandë, pronat e qytetarëve shqiptarë? Pa akte, pa i dhënë një copë letër. Sepse diskutojmë neve këtu: diskutojmë

për reformën në drejtësi, diskutojmë për kodin e procedurave administrative, ligjin për gjykatat administrative. Kot i bëjmë ligjet ne. I bëjmë kot ligjet, sepse kjo qeveri sillet si bandë. Ky Kryeministër sillet si bandit me qytetarët. Nuk pyet për ligje. Sillet në mënyrë arrogante. Sillet në mënyrë autoritariste. Dhe gjëja e parë për të cilën qeveria duhet të vijë këtu, dhe që duhet të shqetësojë këtë Komision të Ligjeve, është mënyra e sjelljes së një qeverie si një qeveri evropiane. Pastaj t'i kërkojmë neve llogari qytetarëve, pastaj të marrim neve masa ndaj qytetarëve. Ne kemi sot një qeveri, e cila nuk ka ndërmend të ecë në rrugën e Bashkimit European, nuk ka ndërmend të përmirësojë standardet e të drejtave të njeriut, standarde të Bashkimit European, por po ndjek rrugën e shkurtër në gjithçka, dhe rruga e shkurtër është rruga e totalitarizmit, e një sistemi autoritarit, rruga e një sistemi ku Kryeministri dhe qeveria sillen si bandë. Bandë me studentët, bandë me qytetarët që nuk paguajnë energjinë, bandë me qytetarët në pronat e tyre, dhe bandë nga mëngjesi deri në darkë, duke shembur në dru qytetarët nga Jugu në Veri.

Këto janë çështje që duhet të shqetësojnë këtë komision. Këto janë çështje që duhet të shqetësojnë qeverinë. Për këto çështje duhet të mbledhet Komisioni i Ligjeve e t'i kërkojë qeverisë plotësimin e standardeve, dhe jo të hartojmë ligje të cilat janë vetëm dogmatike dhe jo pragmatiste. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Është e drejta juaj që një ligj të tillë të rëndësishëm ta quani dogmatik, por nuk është e drejta juaj t'i devijoni thelbit të çështjes, për të bërë politikën e ditës. Gjithsesi, un do t'ju këshilloja që ju ta mbyllni me sukses komisionin e 21 janarit, se nuk e keni mbyllur akoma. Mbasi t'i keni gjetur autorët e vrasjes së 21 janarit, hajdeni e flisni këtu për të drejtat e njeriut.

Zoti Fino, për procedurë.

Bashkim Fino – Zoti kryetar! Unë kam një gjë shumë të thjeshtë për procedurë, edhe me parafolësin, në mënyrë shumë të kulturuar.

Tani, ne jemi duke folur këtu për një projektligj “Për këshillin Kombëtar të Integritetit”. Po bëjmë pyetje. Kemi këtu kryetaren e Komisionit të Integritetit. Hajde të diskutojmë për këto çështje! Pasi ta mbyllim këtë dhe ta miratojmë, në qoftë se duam të kërkojmë nesër, pas një muaji, apo pas dy muajsh, një informacion më të hollësishëm, se çfarë ka bërë ky këshill, e ta lidhim edhe me këto që tha zoti Halimi, absolutisht unë besoj se zonja Bregu dhe zoti Balla do të

ishin të gatshëm të na vinin herë pas here në komision, se kështu e thotë ligji, që të na raportojnë e të flasin për këtë gjë.

Por, të flasim paraprakisht për gjëra që nuk e dimë dhe për gjëra me të cilat duam të bëjmë politikë këtu, ndërkohë që ne kemi projektligjin, mua nuk më duket normale.

Sepse na u fol tërë kohën për bandat, dhe u tha se ky komision duhet të mbledhet për këtë çështje. Po e thamë pra, në fillim të komisionit. E kërkuan kolegët tanë. Të mbledhim Komisionin për të drejtat e njeriut, ta zgjidhim këtë problem. Por nuk mund të na mbajnë peng e të na tërheqin zvarrë tani kot, të bëjnë diskutime politike, kur kemi një diskutim për Këshillin Kombëtar të Integritetit. Do t'ju lutesha edhe ju si kryetar komisioni, keni të drejtën tuaj ta ndërprisni diskutimin dhe të vazhdojë tjetri, në funksion të procesit dhe të projektligjit që kemi. Ju lutem! Se s'kemi kohë të tepërt për të humbur.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zoti Peza, fjala për ju.

Dashamir Peza – Faleminderit, zoti kryetar!

Më lejoni t'i kërkoj ndjesë kryetares së Komisionit të Integritetit për gjuhën e përdorur këtu në komision dhe ta siguroj se jo të gjithë ne mendojmë se ky ligj është i pavlefshëm, që nuk ka nevojë të diskutohet këtu. Unë mendoj se ky ligj është shumë i vlefshëm dhe më duket një shpërthim, emocional fakti se dikush nga kolegët e mi, që unë e respektoj shumë për pozicionin që ka, ta paraqesë si të panevojshme punën tonë në këtë komision dhe si veprim a si kalim i një ligji që nuk ka nevojitet. Unë, përkundrazi, mendoj se kjo është një gjë që na nevojitet shumë. Gjithashtu, shumë sinqerisht, dua t'i kërkoj zotit Halimi, që t'i tërhiqte fjalët që adresoi në drejtim të policisë së shtetit, sepse ne jemi Komision Ligjesh, jemi deputetë të Kuvendit të Shqipërisë dhe nuk është në nderin tonë që të përdorim këtu në Komisionin e Ligjeve terma, të cilët nuk i shkojnë për shtat askujt, jo më një përfaqësuesi në Kuvendin e Shqipërisë. Do të thosha se është pak e papranueshme ose shumë e papranueshme, që të përmenden në diskutimet tona çështje që marrin përsipër të vendosin nëse një grevë është e ligjshme apo e paligjshme, sepse nuk është ky institucioni. Ne po diskutojmë për të gjitha gjërat që nuk kanë lidhje me ligjin, të cilin e kemi në diskutim, por po marrim përsipër edhe të bëjmë rolin e gjykatës e të prokurorisë, për të përcaktuar nëse një protestë apo një aksion i caktuar i qytetarëve shqiptarë, t'i vëmë...

(Diskutime pa mikrofon)

Më lejo se nuk të kam thënë asnjë fjalë.

T'u vëmë emra, nëse janë të ligjshme apo janë të paligjshme.

E dyta, dua të kujtoj këtu...

(Diskutime pa mikrofon)

Kam dhimbje më të mëdha, zoti Halimi; jam i shqetësuar për çdo veprim që bën policia, por në memorien time dhe në kujtimet e mia çështja e 21 janarit është një çështje e pashlyeshme, gjë për të cilën do të kërkoja edhe bashkëpunimin tuaj, që së bashku të përpiqemi të gjejmë ata njerëz nga policia e shtetit, që vranë njerëz të pafajshëm ditën e 21 janarit dhe më pas, bashkë me këtë, të diskutojmë edhe për çështje të tjera, por në mënyrë të përgjegjshme dhe jo me emocione e me epitete dhe me shpërdorim të gjuhës duke iu shmangur thelbit të diskutimeve, të cilat po i bëjmë këtu në komision.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju lutem, nuk ka replika.

Eduard Halimi - Zoti Peza, e thashë në fillim, kjo opozitë ka qenë dhe do të jetë pro e çfarëdo ligji që ka të bëjë me integrimin. Se çfarë keni bërë ju kur keni qenë në opozitë, se ku keni shkuar, në greva, bllokime e me radhë për çdo ligj që është bërë për integrimin, kjo është çështje që është në memorien e qytetarëve, është e ngulitur dhe nuk ka nevojë për t'u rikthyer, sepse e dimë pozicionin e njëri –tjetrit.

Lidhur me deklaratat me Policinë e Shtetit, ju thashë se nuk është Policia e Shtetit, por janë segmente të saj, të cilat, të inspiruara personalisht nga Kryeministri, po sillen si bandë dhe si banditë duke dhunuar grupe studentësh në mes të natës.

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, unë e kuptoj shumë mirë që ke marrë detyrën në kryesi të partisë, por nuk duhet ta kthesh Komisionin e Ligjeve...

Këtu keni ardhur për një ligj dhe respektoni rendin e ditës, po deshët, po nuk deshët mos flisni fare.

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Hysi, e ka fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në cilësinë e relatores mendova që diskutimi në parim pastaj nën për nën i këtij projektligji do të bëhej në frymën që kërkon Bashkimi European dhe në frymën që kërkon vetë projektligji, të cilin e kemi objekt diskutimi. Të them të drejtën ndihem keq me kolegët e opozitës për dy arsye:

Së pari, në plan më të ngushtë kjo është nismë e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe është për t'u përshëndetur dhe për t'u lavdëruar, dhe po mendoja që të gjitha grupet parlamentare, të gjithë deputetët, që përfaqësohen në këtë komision duhet të diskutojnë në atë frymë që kërkon raport-progresi i Bashkimit European, pra të kemi një debat konstruktiv, bashkëpunim politik, të përdorim etikën, pra të jemi më të kujdesshëm.

Së dyti, çfarë bën ky projektligj? Rrit angazhimin e Kuvendit dhe një nga pikat kërkon që ne të nxisim bashkëpunimin, gjuhën, dialogun politik dhe të flasim me përgjegjësi për projektligjet dhe standardet që kërkojmë të miratojmë në këtë Kuvend.

Së fundmi, para se të kalojmë në diskutimin nën për nën, pasi edhe unë kam pyetje, komente dhe sugjerime për disa nene të veçanta të këtij projektligji, është mirë që në këtë komision të mos flasim për banda, pasi folëm për çdo lloj të ashtuquajtura banda të tjera dhe vetëm për bandën e tritolit nuk folëm.

Do t'ju sugjeroja të kalonim në diskutimin nën për nën.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, sigurisht, ky projektligj është me rëndësi shumë të madhe, sepse nga një ligj deklarativ ne sot kalojmë në një ligj, i cili me të vërtetë krijon një instrument, që do të garantojë një kontroll të parlamentit mbi ekzekutivin. Kjo është një nga temat e rëndësishme që Komisioni European ka ngritur prej kohësh dhe materializohet mbi këtë projektligj. Parlamenti të kontrollojë punën e qeverisë, sesi po punon qeveria dhe sa po punon në procesin e integrimit europian.

U tha edhe më herët këtu, se kemi një vit e gjysmë që në vend të dëgjojmë për integrimin europian jemi duke dëgjuar vazhdimisht deklarata njëra pas tjetrës të Kryeministrit me doza euroskepticizmi: ose do të na fusë në nën shtetull Bashkimi European, dhe të na mbrojnë nga terrorizmi islamik, ose ne duhet të na pranojë Bashkimi European sepse përndryshe vendet e Ballkanit Perëndimor do të kthehen në problem për krimin e organizuar, për Bashkimin European, apo të na marrë pasi nuk presim dot më se jemi lodhur. Vendet e Ballkanit Perëndimor

janë lodhur dhe nuk mund të presin gjatë dhe se do të shohin interesin e tyre. Doza të tilla euroskepticizmi nuk janë absolutisht në përputhje jo vetëm me axhendën e madhe të integritetit evropian, por as me pesë prioritetet e përcaktuara nga Bashkimi Evropian për Shqipërinë.

Kështu që, unë shpresoj që ky instrument, Këshilli Kombëtar i Bashkimit Evropian, që është edhe struktura më e lartë do të rrisë maksimalisht efikasitetin në këtë aspekt.

Dua të ndalem vetëm te një nga pesë këto prioritetet. Të gjitha janë shumë të rëndësishme, por prioriteti numër pesë ai për të drejtat e njeriut, sot është një temë themelore e diskutimit që ky komision, ky parlament, shoqëria civile, pra opinioni publik duhet të bëjë në Shqipëri.

Fatmir Xhafaj – *(I drejtohet zotit Taulant Balla)* Po ike ti, unë do ta ndërpres mbledhjen.

Oerd Bylykbashi - Mbledhja nuk ndërpritet derisa të mbarojmë ne.

Fatmir Xhafaj – Po çfarë mund t'i them unë atij.

Oerd Bylykbashi - Zoti Balla, mund edhe të lëvizësh, se nuk na intereson shumë. A ka mundësi të mos ndërhysh, se po flas.

Zoti kryetar, a ka mundësi t'ia ndërpresësh fjalën të ftuarit.

(Diskutime pa mikrofon)

Oerd Bylykbashi - Në lidhje me të drejtat e njeriut, jemi përpara një liste të frikshme të dhunimit të këtyre të drejtave dhe nëse ne flasim për instrumente kontrolli, ligje të reja dhe nuk zbatojmë ato që janë dispozita kushtetuese dhe dispozita ligjore ekzistuese, e kemi kot.

Rastet e dhunimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve shqiptarë, i kemi parë në Kavajë, i kemi parë në Korçë, i kemi parë në Durrës, dhe i fundit ishte rasti i nxjerrjes me dhunë të studentëve nga greva.

Është e drejtë kushtetuese tubimi paqësor i studentëve, është e drejtë kushtetuese e drejta e tyre për grevë. Arsyet janë të studentëve dhe nuk është çështja jonë për ta diskutuar, por t'i dhunosh ata nuk ka ndodhur ndonjëherë deri më sot. Nëse ne nuk e ngremë këtë shqetësim, sigurisht nuk do të jetë as në axhendën e Këshillit Kombëtar për të shtrënguar frerët e kësaj qeverie, që një gjë thotë në programin saj dhe tjetër gjë bën për këtë çështje. Ne nuk mund të sillemi si burokratë me të drejtat e njeriut.

Të drejtat e njeriut janë kryefjala e diskutimit politik dhe jopolitik në këtë shoqëri, përndryshe ne nuk jemi përpara një demokracie, por të një oligarkie, autokracie, quajeni si të

doni. Unë shpresoj që, nëpërmjet këtij ligji, do të kemi mundësinë që ta kthejmë këtë qeveri në axhendën e integritit europian.

Të kthehemi tek ajo për të cilën qeveria paraardhëse vuri si lajtmotiv të aksionit të vetë politik integritimin europian të bazuar në meritë dhe në standarde, atë që kjo qeveri nuk po e bën.

Ne arritëm të bëjmë nënshkrimin e MSA-së, ratifikimin e saj, aplikimin për status, e sollëm deri në derën e statusit, por ju e bllokuat. Ne bëmë që të anëtarësohemi në NATO, liberalizuam vizat, dhe të gjitha këto procese integruese kanë qenë të bazuara mbi standarde, të cilat garantojnë të drejtat e njeriut dhe nuk mund të vriten, përndryshe e gjithë ngrahina që ne kemi ngritur vlen zero lek.

Kështu që, duke e mbështetur plotësisht këtë projektligj dhe këtë iniciativë ajo që unë do të kërkoja është që sapo të ngrihet ky këshill, vërtet të jetë një instrument shumë i fortë monitorimi mbi veprimin e qeverisë në përmbushjen e standardeve, dhe mbi të gjitha, në lidhje me të drejtat e njeriut.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

A ka të tjera diskutime? Nuk ka? Po, zonja Bregu!

Majlinda Bregu – Duke ju falënderuar për diskutimin në komision të këtij projektligji, më lejoni që të them se propozimet dhe vërejtjet tuaja ne do t'i marrim parasysh!

Nesër Komisioni i Integritit ka mbledhjen më duket, dhe duke qenë se është komisioni përgjegjës do ta shqyrtojnë për ta paraqitur ligjin ditën e enjte në seancë plenare. Unë pavarësisht se kam ndërruar derën e komisionit, sot nuk jam bërë njeri tjetër dhe apolitik. E kam të qartë shqetësimin që është prezent në këtë komision dhe sigurisht që do të jetë prezent edhe në Komisionin e Integritit.

Ky ligj, me gjithë dëshirën time të mirë, tuajën, dhe të gjithë kolegëve sikurse edhe çdo ligj tjetër në këtë vend duke filluar nga Kushtetuta, nuk na e siguron dot zbatimin e standardeve europiane. Në rast se nuk ka përgjegjshmëri dhe vullnet politik, nuk ka ligj në botë sado mirë të jetë hartuar ai që ta sigurojë.

Në rast se ka një diskutim sot kur ngrihen shqetësime për çështje që janë prioritet dhe detyrime për t'u zbatuar në procesin e integritit europian, vjen vetëm për faktin se ato çfarë i kemi detyrime me ligj...

Fatmir Xhafaj - Zonja Bregu, ju lutem, diskutimet lërin për në seancë plenare. A keni ndonjë gjë për të thënë lidhur me projektligjin?

Majlinda Bregu – Për projektligjin po flas dhe nuk po dal nga tema, sikurse e sheh, zoti Xhafaj. E përsëris edhe një herë falënderimin, jam shumë e qetë.

Besoj se ka një keqkuptim për Këshillin Kombëtar, i cili nuk do të jetë instrumenti që do të monitorojë zbatimin e këtyre detyrimeve, sepse zbatimin e detyrimeve e bën ligji në tërësi, pra rolin e shtuar të parlamentit ...

Fatmir Xhafaj – Mos ma sqaroni mua këtë gjë, por kolegëve tuaj!

Majlinda Bregu – Zoti Xhafaj, ju jeni kryetari i komisionit dhe të dy i kemi mikrofonat e ndezur, ndaj po e sqaroj për të gjithë.

Ky ligj dhe Këshilli Kombëtar nuk do të jetë instrumenti, i cili do të kontrollojë qeverinë. Ligji ju jep instrumentin për një kontroll më të mirë parlamentar ndaj qeverisë në procesin e integritetit dhe këshilli do të jetë një organ konsultativ për të gjithë ne. Qeveria të detyrohet të mos marrë vendime duke filluar edhe nesër me kuadrin e negociatave, pa u konsultuar me parlamentin, pra me institucionin kryesor në procesin e integritetit.

Duke ju falënderuar edhe një herë, po shkoj të marrë opinionet e shoqërisë civile!

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit ! Ne e ndërpresim këtu dhe kur të ketë një përfaqësues nga ju, do të vazhdojmë mbledhjen e komisionit dhe të shpëtojmë retorika politike.

Majlinda Bregu – Zonja Kejdi Mehmetaj do të vijë në komision.

Fatmir Xhafaj – Të vijë, që të fillojmë, se unë pa njeri nuk e vazhdoj. E ndërpresim këtu këtë pikë, për ta vazhduar më mbrapa.

Vazhdojmë me marrëveshjet, nëse do ketë njëri do të vazhdojmë pas dy marrëveshjeve, nëse nuk do ketë përfaqësues nga grupi nismëtarë do të vazhdojmë kur të jetë kalendari.

Nuk është përgjegjësia ime, kështu që ligjet e zakonshme kthehen në retorika politike dhe zgjatet debati pa fund.

(Diskutime pa mikrofon)

Vazhdojmë me diskutimin nën për nen të projektligjit “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.

Zoti Balla është prezent? Po.

Vazhdojmë me nenin 1.

Vasilika Hysi –Për nenin 1 nuk kam asnjë koment.

Fatmir Xhafaj – Ka komente? Relatorja nuk ka komente, ka nga kolegët?

Nuk ka.

Neni 2, objekti?

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 2, kam një sugjerim për riformulim, ku thuhet që “Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për marrëdhëniet e Kuvendit me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e Bashkimit European në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj - Ju lutem! Dakord.

Neni 3.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 3, në fjalinë e parë, të më ndjekë propozuesi, të heqim fjalën “kryesore”, sepse Kuvendi ka një sërë funksionesh dhe këto janë funksione.

Te neni 3, fusha e veprimit të ligjit ku thuhet “ Ligji e shtrin veprimin e tij mbi funksionet kryesore të Kuvendit që kanë të bëjnë...”. Funksioni kryesor i Kuvendit është edhe hartimi i ligjit, pra le të themi se “ligji e shtrin veprimin me funksionet e Kuvendit që kanë të bëjnë me”, të hiqet fjala “kryesore”.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Neni 4.

Vasilika Hysi – Jo, këtu lidhur me shkronjën “b”, ju thoni “monitorimin e zbatimit të kuadrit normativ”. Duhet saktësuar, “akti normativ që ka të bëjë me integrimin european”, se ligji ka të bëjë me integrimin european.

Fatmir Xhafaj - Po kuptohet ajo.

Vasilika Hysi – Dakord. Lidhur me germën “c” “Për informimin e publikut për ecurinë e etapave të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European dhe bashkëpunimin më shoqërinë civile në këtë proces”, të shtohet fjala “në këtë proces”.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Ka vërejtje të tjera? Jeni dakord me sugjerimet?

Miratohet.

Neni 4.

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 4, është vetëm një saktësim drejtshkrimor të germa “c”, ku thuhet se “fondet e Bashkimit European janë fonde që akordohen nga Bashkimi European për mbështetjen e vendit tonë në plotësimin e kriterëve”, pra, të hiqet pjesa “që kanë si qëllim”.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Kemi gjë tjetër?

Miratohet.

Neni 5. “Parimet e përgjithshme”.

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 5, kam vetëm një plotësim, të shtohet “dhe liritë themelore”, pra të thuhet: “Një ndër parimet është mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij”.

Fatmir Xhafaj - Tamam, këtë që duhej ta thoshte opozita, mbajti gjithë atë fjalim dhe nuk e tha.

Neni 5.

Dakord.

Neni 6.

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 6, i nderuar zoti kryetar, unë kam të drejtën e bërjes së pyetjeve dhe të komenteve, por kam katër çështje që dua t’i diskutoj.

Çështja e parë ka të bëjë me përbërjen e këtij Këshilli. Këshilli është një organ i lartë konsultativ dhe thuhet se e drejton kryetari i komisionit parlamentar dhe si zëvendëskryetar është kryesuesi. Unë do të isha në parim që drejtimin e këtij Këshilli ta bëjë gjithmonë një përfaqësues i opozitës.

Fatmir Xhafaj - Dakord, e kemi thënë këtë. Tjetër?

Vasilika Hysi - Dhe nënkryetari të jetë gjithmonë nga maxhoranca. Kemi një përbërje të tillë, ku kryetari i Komisionit të Integritetit vjen nga opozita, kryetari i delegacionit është nga opozita. Pra, të jetë gjithmonë kusht, kryetari dhe nënkryetari t’i përkasin opozitës e maxhorancës.

Pika e dytë që do të doja të diskutoja është në lidhje me shqetësimin që ngriti pjesa tjetër e kolegëve. Ka përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në çështjet e integritetit. Janë disa organizata aktive, sa do të jetë numri i përfaqësuesve? Kush do t’i përcaktojë ata? Pra, duhet përcaktuar, të paktën të propozohet në ligj, duhet të përbëhet nga 3 ose 4, 5, 2, apo 1 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile.

Fatmir Xhafaj - Dakord, u kuptua.

Vasilika Hysi - Gjithashtu, për pikën 6 të këtij neni, ku thuhet se “Përgjegjësitë e organizimit dhe të funksionimit, Këshilli i përcakton në Rregulloren e drejtuar prej Kuvendit”, nuk jam dakord, zoti kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

I miratuar prej tij thuhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Dakord. Unë kam dy sugjerime. Në radhë të parë, përgjegjësitë e këtij Këshilli duhet të përcaktohen në ligj, krijojmë një këshill shumë të rëndësishëm dhe nuk mund të lihet parashikimi në një nen.

Fatmir Xhafaj - Janë të parashikuara në ligj.

Vasilika Hysi - Jo, nuk janë.

Fatmir Xhafaj - Janë te përgjegjësitë e Komisionit të Integritit.

Vasilika Hysi – Jo. Është këshill ky, zoti kryetar. Krijohet një këshill konsultativ pranë Kuvendit dhe, kur komisioni merr kompetenca të jashtëzakonshme, është gjë tjetër, janë dy gjëra të ndryshme.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord.

Vasilika Hysi - Dhe ajo që unë kam pyetje është se në ç’raport do të jetë Këshilli Kombëtar i Integritit Kombëtar me komisionet e përhershme, me Komisionin e Integritit European dhe me Kuvendin në tërësi? Pra, është diçka konsultative. Kë do të konsultojë? Do të konsultojë Kryetarin e Kuvendit? Do të konsultojë çdo komision të përhershëm parlamentar? Apo do të konsultojë Komisionin e Integritit European? Këto gjëra nuk janë të qarta.

Fatmir Xhafaj - Keni gjë tjetër për nenin 6?

Po, zoti Bylykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi - Zoti kryetar, pika 3 përbëhet nga të ftuar me statusin e përhershëm, një sërë funksionarësh apo grupesh. Unë besoj se një gjë që mungon këtu janë edhe sindikatat. Vërtet kemi ne edhe organizatat e biznesit edhe të dhomave të tregtisë, por edhe sindikata është një grup interesi që duhet të përfshihet. Ju takon edhe juve ta ngrini si çështje.

(Diskutime pa mikrofon).

Në mos gaboj, zoti Mediu, që nuk është këtu, ngriti dhe bëri propozimin që të jenë të përfshirë edhe kryetarët e grupeve parlamentare në përbërjen e Këshillit. Këto janë dy propozimet që unë kisha.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Taulant Balla - Kjo është pikë e diskutueshme.

Për sa i përket çështjes së parë për drejtimin, fakti që drejtimi i tij është caktuar në projektligj, që kryetari është kryetari i Komisionit të Integritetit dhe nënkryetari është kryetari i delegacionit në Komitetin Parlamentar të Stabilizimit-Asociimit Shqipëri- BE, është e përcaktuar që kryetari është i opozitës dhe nënkryetari është i maxhorancës për shkak se ky rregull parlamentar tashmë është e konsoliduar.

Ky është viti i 12-ë që funksionon Komisioni Parlamentar i Integritetit, që historikisht drejtohet nga opozita dhe është viti i 7-të që ka Komitet Parlamentar të Stabilizimit-Asociimit dhe kryetari i delegacionit është i maxhorancës. Kjo ka qenë edhe arsyeja mbi të cilën ne kemi dakorduar qëndrimin me zonjën Bregu dhe zonjën Tabaku, që ky lloj parimi i konsoliduar të vazhdojë më tej dhe ka garantuar se edhe në ligjet e tjera është e konsultuar. Nuk është e thënë që kryetarit i takon, por është nisur nga parimi që kryetari i Komisionit të Integritetit gjithmonë është i opozitës.

Lidhur me pikën tjetër, për sa i përket numrit të shoqërisë civile...

Fatmir Xhafaj - Po, caktoni një numër.

Taulant Balla - Jo. Nuk mund ta caktojmë këtu, por do të caktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm që miratohet nga Byroja e Kuvendit. Atje do të caktohet. Ne jemi duke diskutuar me shoqërinë civile tani, dhe shoqëria civile vetë ta ndajë, sepse ju mund të caktoni aq sa janë të gjithë këta dhe të jetë më shumë shoqëri civile sesa institucione. Ligji këtë ka.

Taulant Balla - Zoti kryetar,

Më lejoni t'ju them se në këshill nuk ka votim.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk ka rëndësi, por ka funksion. Natyra e organit është organ parlamentar.

Taulant Balla – Këshilli nuk është vetëm parlamentar, por është organ këshillimor. Kjo është thënë në pikën e parë të nenit 6. Këshilli Kombëtar i Integritetit është struktura më e lartë këshillimore. Kështu që ne duam të rrisim sa më shumë numrin e atyre të cilët këshillohen me ne për këto çështje. Në rregullore do ta specifikojmë qartë se sa do të jetë numri, sa do të jenë nga shoqëria civile.

Shkojmë te çështja që ngriti zoti Bylykbashi, për sa u përket përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Unë mendoj që ta lëmë “përfaqësues të grupeve parlamentare”. Kryetari i grupit parlamentar në daç vihet vetë, daç çon përfaqësues, kjo është çështje e tij. Kjo që të jemi korrekt dhe me zotin Mediu.

Për sa i përket fjalës sindikatë, ne e kemi marrë këtë, le të themi, rekomandim. Por përsëri insistoј që fakti se kemi përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, është e vërtetë që ka dallime të përkufizimit, nëse brenda shoqërisë civile bëjnë pjesë sindikatat. Unë bëj pjesë tek ata që mendoj se dhe sindikatat janë pjesë e shoqërisë civile. Në Komisionin e Integritit, që jemi komisioni përgjegjës për shqyrtimin e kësaj çështjeje, do ta diskutojmë dhe mendoj se do ta marrim parasysh rekomandimin.

Fatmir Xhafaj – Te pika 6: “Përgjegjësitë, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Ministrave përcaktohet në rregulloren e miratuar “.

Taulant Balla - Prej byrosë së Kuvendit.

Fatmir Xhafaj - Ky është ligj dhe byroja nuk mund të dalë mbi normativën e një ligji. Nuk mund t'i caktojë byroja përgjegjësi një organi të krijuar me ligj nga Kuvendi. Kështu që ju vendosni këto, por përgjegjësitë parashikohen nga ky ligj. Atëherë do të duhet të thoni vetëm: “organizimi dhe funksionimi i këshillit përcaktohen nga rregullorja e miratuar”.

Biem dakord? Po.

Majlinda Bregu – Në fakt e kemi diskutuar, por pastaj ishin gocat e zyrës...

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 7 unë jam dakord në parim. Kam vetëm një pyetje. Pse nuk përcaktohet numri i sekretariatit dhe numri i ekspertëve të pavarur? Kush do t'i përzgjedhë ekspertët?

Fatmir Xhafaj - Rregullorja e Kuvendit ka një përcaktim si merren ekspertët e jashtëm.

Vasilika Hysi – E them këtë, sepse ky projektligj nuk ka faturë financiare. Po ta lexosh me vëmendje ky projektligj sjell shtesa, ka kosto dhe faturë financiare. A do të ketë një numër të përcaktuar të përbërjes së anëtarëve të Këshillit Konsultativ të Sekretariatit dhe ku përcaktohen kompetencat e sekretariatit?

Fatmir Xhafaj – Ligji nuk është rregullore dhe nuk duhet të marrë natyrën e rregullores. Detyrat se çfarë mund të bëjë sekretariati mund t'i përcaktojnë shumë mirë në rregullore. Sekretariati janë shërbimet e Kuvendit. Ata nuk kanë faturë financiare, sepse është një

drejtori e Integritetit. Ajo siç punon për komisionet do të punojë dhe për këtë gjë. I njihet sot, është me Rregulloren e Kuvendit që ekspertët paguhën kur caktohen.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, e bëra këtë pyetje sepse deri tani sekretariati teknik ngrihet për një këshill që nuk është pjesë e Kuvendit. Por po e ngre me këtë ligj si organ këshillimor. Në qoftë se do të jetë pjesë e Kuvendit, atëherë do të zbatohet Rregullorja e Kuvendit. Nuk i referohet Rregullores së Kuvendit në shumicën e rasteve. Dhe unë e kam pyetje dhe në vazhdimësi për disa nene. Herë i referohet herë nuk i referohet, por gjithçka rregullohet me një ligj të veçantë

Fatmir Xhafaj – Prandaj rregullohet me një ligj të veçantë që të ketë mundësi që kur është e rregulluar në këtë ligj do të zbatohen dispozitat e këtij ligji. Kur nuk është e parashikuar në këtë ligj do të zbatohet automatikisht rregullorja. Ky është kuptimi dhe i komisioneve të tjera.

Vasilika Hysi – A mund të thuhet se organizimi, funksionimi dhe kompetenca e sekretariatit përcaktohen në rregullore?

Fatmir Xhafaj – Është e përcaktuar. Dakord shto miell shto ujë!

Neni 8. Komitetit parlamentar për stabilizim-asocimimin besoj se është i qartë.

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim. Ju thoni se komiteti përbëhej nga anëtarë të Parlamentit Europian dhe anëtarë. Dhe për aq sa është e mundur në paragrafin e dytë shtoni: “për aq sa është e mundur anëtarët e këtij komiteti duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Integritetit”. Faktikisht në qoftë se ne nisemi nga përbërja aktuale e komitetit parlamentar nuk është kështu.

E para, në qoftë se do të bëni këtë lloj parashikimi, do ta rishikojmë përbërjen e komitetit parlamentar aktual, pra do ta zhbëjmë atë për të bërë një komitet?

Dhe e dyta, Komisioni i Integritetit Europian që ka sot i plotëson kapacitetet nga përbërja e tij që t’u përgjigjet kërkesave të integritetit? Unë nuk e kam parasysh përbërjen, prandaj e kam pyetje.

Taulant Balla – Fjala “për aq sa është e mundur” e ka rregulluar këtë pjesë. Ndërsa për sa i përket pjesës që: “grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvendin e Shqipërisë duhet t’i kushtojnë më shumë vëmendje përbërjes së Komisionit të Integritetit” kjo është çështje që në vlerësimin e grupeve parlamentare duhet ta bëjmë një gjë të tillë. Ne e kemi vendosur këtë dhe kërkojmë që ta mbajmë domosdoshmërisht këtë rregullim në gjuhën e shkruar në paragrafin e dytë, për arsye sepse i njëjti paragraf është në Parlamentin Europian, për sa i përket

delegacioneve me vende të caktuara ku në Rregulloren e Parlamentit European thuhet se: “në delegacionet e Parlamentit European, për aq sa është e mundur, synohet që të jenë anëtarë të AFET-it”, Komisionit të Jashtëm. E njëjta gjë ndodh dhe atje. Jo të gjithë anëtarët e delegacioneve janë anëtarë të AFET-it, sepse AFET-i ka 56 anëtarë, ndërsa në delegacion janë 180.

Fatmir Xhafaj – Të mos hyjmë në detaje. Mua më duket se është e qartë.

Majlinda Bregu – Vetëm në qoftë se do të ishte që “anëtarët e Komisionit të Integrimit të jenë për aq sa është e mundur të jenë anëtarë të këtij komiteti”.

Taulant Balla – Po është e njëjta gjë.

Fatmir Xhafaj – Është qartë i formuluar kështu siç është.

Vasilika Hysi – Rregullorja e Kuvendit në nenin 7, pika 3 e ngarkon Kryetarin e Kuvendit që në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare të përcaktojë listën e anëtarëve të komitetit parlamentar për stabilizim-asociim dhe të gjitha delegacionet e tjera. Në rast se ju thoni për aq sa është e mundur anëtarët e këtij komiteti duhet të jenë anëtarë të Komisionit të Integrimit, po e vutë dhe nuk e zbatoni, i bie pastaj...

Fatmir Xhafaj – Kur nuk është e mundur.

Oerdi thotë që mund ta bëni dhe si rregull.

Neni 9. Komisioni për Integrimin European.

Vasilika Hysi – Neni 9 është një rimarrje e nenit 19, paragrafi 3 i rregullores së Kuvendit. Është fjalë për fjalë. Nuk ka asgjë të keqe. Mund ta lëmë. Në qoftë se do ta lëmë, dhe duhet lënë, duhet riformuluar sipas Rregullores së Kuvendit. Pra, formulimi të bëhet sipas paragrafit 3 të nenit 19 të Rregullores së Kuvendit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 10. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit në çështjet evropiane.

Vasilika Hysi – Ka vetëm një gabim në pikën “a” kur thuhet: “mbikëqyr dhe kontrollon zbatueshmërinë e kuadrit ligjor”, jo të këtij kuadri ligjor.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 11. Ndërveprimi me institucionet e Bashkimit European.

Vasilika Hysi - Jam dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 12. Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave .

Vasilika Hysi - Lidhur me përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave do të sillja në vëmendjen tuaj që përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave janë përcaktuar në ligjin nr.9000 të vitit 2003. Nuk mundemi ne që në një ligj tjetër, kur ka një ligj specifik, të përcaktojmë përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave. Do të doja të sillja në vëmendjen tuaj që në këtë ligj ka një nen të veçantë ku thuhet: “Këshilli i Ministrave përcakton një nga ministrat e vetë që të bashkërendojë punën e Këshillit të Ministrave me programin e Kuvendit”. Në këtë kuadër nuk mund të themi që Këshilli i Ministrave me kërkesë të Kuvendit informon, por mund që nëpërmjet ministrit të Marrëdhënieve me Parlamentin të informojë Kuvendin lidhur me gjithçka tjetër. Këtu ka një problem. Ne nuk mund të përcaktojmë në këtë ligj, Majlinda, kompetencat, përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave. Përgjegjësitë i ka të përcaktuara në ligjin nr. 9000.

Taulant Balla – Neni 12 në projektligj është siç është neni në ligjin e vjetër të vitit 2004. Nuk ka ndryshuar asgjë. Këtu nuk flasim për përgjegjësitë tërësore të Këshillit të Ministrave, por flasim për përgjegjësitë specifike të Këshillit të Ministrave në procesin e integritetit. Dhe po të lexoni pikat “a”, “b”, “c”, “ç”, etj., kanë të bëjnë vetëm me procesin.

Fatmir Xhafaj – Nuk është tamam ashtu. Në një farë mënyre kjo është marrëdhënia e Këshillit të Ministrave me Kuvendin. Pra, llogaridhënia e Këshillit të Ministrave para Kuvendit. Kështu që gjeni një formulim tjetër.

Taulant Balla – Keni të drejtë, sepse titulli i nenit është formuluar gabim. Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave ose duhet specifikuar në procesin e asaj, ose në marrëdhënie me Kuvendin.

Fatmir Xhafaj – Në marrëdhënie me Kuvendin.

Taulant Balla – Atëherë mund t’i themi detyrimet në marrëdhëniet me Kuvendin.

Vasilika Hysi – *(Zonja Hysi flet pa mikrofon.)*

Taulant Balla – Kuvendi është më lartë se qeveria dhe duhet një fjalë...

Fatmir Xhafaj – Është detyrimi i Këshillit të Ministrave në marrëdhëniet me Kuvendin.

Taulant Balla – Detyrimet e Këshillit të Ministrave në marrëdhënie me Kuvendin gjatë procesit të Integritetit Evropian.

Fatmir Xhafaj – Kalojmë te neni 13. Përgjegjësitë e komisionit për Integritetin Evropian.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 13 unë kam dy shqetësime.

I pari lidhet me përputhshmërinë e përmbajtjes së këtij neni me rregulloren e Kuvendit. Konkretisht në nenin 19 në pikën 1 të Rregullores së Kuvendit përcaktohen fushat e përgjegjësisë që kanë komisionet e përhershme parlamentare. Ndërkohë ju në nenin 13 i jepni Komisionit të Integritimit Europian më shumë kompetenca sesa i ka dhënë Rregullorja e Kuvendit. Dhe këtë e pasqyroni që në paragrafin e parë të këtij neni ku thoni se Komisioni për Integritimin Europian në përmbushje të funksionit të tij ushtron edhe këto përgjegjësi. Sugjerimi im është që përmbajtja e nenit 13 të këtij projektligji të jetë në përputhje me nenin 18 dhe 19 të Rregullores së Kuvendit, të ketë parasysh kompetencat që kanë edhe komisionet e tjera, se janë 8 komisione të përhershme. Nuk mundet që Komisioni për Integritimin Europian, pavarësisht rolit shumë të rëndësishëm dhe deciziv që ka, të marrë të gjitha kompetencat e komisioneve të tjera që janë të përcaktuara në nenin 19.

Gjithashtu, një rast është se përfaqëson Kuvendin e Shqipërisë në bashkëpunimin ndërparlamentar. Sipas pikës “F”, bashkëpunimin, përfaqësimin e Kuvendit nuk e bën Komisioni i Integritimit Europian. Përfaqësimi i Kuvendit ka rregulla të veçanta se kush e bën. Është Kryetari i Kuvendit, ka delegacione, etj. Pra, nuk mundet që Komisioni i Integritimit Europian të jetë tashmë mbi Kryetarin e Kuvendit, mbi komisionet e tjera.

Pika “F”: “përfaqëson Kuvendin e Shqipërisë në bashkëpunime ndërparlamentare”.

Lidhur me pikën “c”. Ju thoni se Komisioni për Integritimin Europian bashkëpunon me organizata të shoqërisë civile për të siguruar informimin dhe pjesëmarrjen e tyre në procesin e integritimit evropian. Këtë lloj kompetence, përgjegjësie e ka çdo komision. Kjo është e rregulluar shumë mirë në ligj. Po të shikoni nenet 105 deri në 108 të Rregullores së Kuvendit bëhet fjalë për transparencën e Kuvendit, flitet me detaje që gjithkush ka të drejtë të informohet. Kemi një ligj për të drejtën e informimit. Kemi një ligj madje edhe më të avancuar për të drejtën e konsultimit dhe nuk është vetëm përgjegjësi e Komisionit për Integritimin Europian. Krijohet përshtypja që ju këtë nuk e keni bërë deri tani, sepse nuk e ka Rregullorja e Kuvendit dhe këtë e përcaktoni në ligj.

Ushtron dhe këtë përgjegjësi... *(Zonja Hysi flet pa mikrofon)*

Taulant Balla – Arsyeja është se edhe për këtë nen parimisht në ligjin e vjetër janë këto kompetenca. Arsyeja pse janë nënvizuar këtu është më shumë nënvizim se sa dalje nga rregullat e përcaktuara. Në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë është që në progres-raportet e BE-së 2007, 2008, 2009, 2010 etj., gjithmonë është kritikuar jo vetëm parlamenti, por në mënyrë të

veçantë Komisioni i Integrimit për kohë të caktuara për problematikat që ka gjetur raporti si mosushtim i kompetencave të veta. Janë marrë fjalët nga progres-raporti dhe janë përshtatur në formë ligjore. Bie dakord që ndoshta formulimi “ushtron dhe këto kompetenca” është gabim. Mund të thoshim “zgjerohet” ose “duhet”.

T’i marrim me radhë. “Shqyrton së bashku me komisionet e tjera parlamentare projektligjet që kanë lidhje me përafrimin e legjislacionit shqiptar”. Rekomandimi i KE-së në progres-raport gjithmonë ka qenë. Ne e kemi pasur këtë deficit që në KE jo gjithmonë vinin ligjet që kishin të bënin me procesin. Pas kritikave të marra Konferenca e Kryetarëve gjithmonë e ka bërë fakt të kryer këtë. Pra, pika “a” nuk besoj se keni gjë kundër.

Pika “b”: “monitoron Këshillin e Ministrave, ministrinë përgjegjëse për çështje të integrimit”.

Taulant Balla – Pikën “f” e hoqëm.

Taulant Balla – Le të jetë kjo pjesa e shoqërisë civile.

Majlinda Bregu – Mund të jetë intensifikon bashkëpunimin. Mund të jetë një gjë tjetër. Bashkëpunon e merr si detyrim. Pra, nuk e lë evazive.

Fatmir Xhafaj – Mua më duket dakord me këto vërejtje.

Dakord.

Neni 14: Plani kombëtar. Dakord.

Neni 15. Nuk ka ndonjë gjë thelbësore.

Vasilika Hysi – Te neni 15 ka diçka të vogël... *(Zonja Hysi flet pa mikrofon.)*

Pra, ia dërgon Kuvendit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Majlinda Bregu – Puna është që të dërgojë të gjithë inventarin e legjislacionit që pretendon të miratojë gjatë vitit.

Fatmir Xhafaj – Në pikën 2 është e qartë që këtë detyrë do ta ushtrojë ky komision. Dakord.

Neni 16. Dakord.

Neni 17. Dakord.

Neni 18.

Vasilika Hysi Në nenin 18 është diçka e vogël në lidhje me raportimet në Kuvend. Nga përmbajtja të krijohet përshtypja se vetëm Komisioni për Integrimin European e ka këtë

kompetencë. Në fakt këtë kompetencë e kanë të gjitha komisionet. Zoti kryetar, mua më shqetëson paragrafi 2, ku thuhet: “Me kërkesë të Komisionit të Integritetit Europian ose 1/3-at e anëtarëve ministri përgjegjës për integrimin thirret për të dhënë informacion për çdo çështje që ka të bëjë me koordinimin e procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në BE”. Njëkohësisht pika 3 i jep kompetencë Komisionit të Integritetit Europian për zbatimin e planit të veprimeve, të parashikuar në politikat sektoriale, ndërsektoriale, të miratuar dhe për çështje specifike të fushave të tjera, pra zgjerohet shumë. Ministri i Integritetit thërret dhe ministrat përkatës...

Më fal, këtu ka komisione përgjegjëse, prandaj po u referohem neneve 18 dhe 19 të Rregullores së Kuvendit, në të cilën përcaktohen komisionet përgjegjëse.

Të krijohet ideja që të gjithë procesin e integritetit e bën vetëm Komisioni i Integritetit Europian, ndërkohë që është përgjegjësi e të gjithë komisioneve, sipas fushës së veprimit të tyre. Kjo duhet pasqyruar.

Majlinda Bregu - Më fal, propozimi këtu nuk u heq të drejtën komisioneve përgjegjëse të thërrasin ministrat, por e detyron Komisionin e Integritetit që të thërrasë ministrin. Pra, ne nuk mund të presim për ta marrë informacionin kur Erion Veliaj të vijë në Komisionin e Ligjeve, por do ta thërrasim te Komisioni i Integritetit për Prioritetin e 5-të, sepse jemi të detyruar të monitorojmë zbatimin e detyrimeve që kanë lidhje me BE-në.

Fatmir Xhafaj - Ideja e zonjës Hysi është që pikën 3 ta saktësoni, me qëllim që të lidhet vetëm me aspektet e procesit të integritetit.

Majlinda Bregu - E kemi thënë: “Politika sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara, si dhe çështje specifike të fushave që lidhen me integrimin europian”.

Taulant Balla - Kjo “që lidhen” është për të dyja.

Fatmir Xhafaj – Qartë, qartë.

Në rregull, le ta lëmë kështu që të kenë mundësi.

Vasilika Hysi – Përsëritja e neni 102 të Rregullores le të lihet, s’ka asgjë të keqe.

Fatmir Xhafaj – Neni 20?

Vasilika Hysi – Neni 20 sugjeroj të shihet në raport me përmbajtjen e nenit 18.

Fatmir Xhafaj - E thamë këtë.

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, është e nevojshme ta sqarojmë nëse raportimi do të bëhet vetëm në këtë komision, apo dhe në komisionet e tjera.

Fatmir Xhafaj – Te Komisioni për Integrimin European dhe komisionet e përhershme.

Vasilika Hysi – Te neni 20, mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së kuadrit normativ të përafrimit të legjislacionit do ta bëjë vetëm Komisioni i Integrimit?

Taulant Balla – Komisioni për Integrimin European e ka të detyrueshme.

Fatmir Xhafaj – Në pikën 2 thuhet: “Komisionet e përhershme të Kuvendit në fund të çdo sesioni përgatitin një raport”. Pra, kjo pikë na detyron edhe ne dhe nuk na e lë fakultative, pra është detyruese.

Neni 20: “Komisionet e përhershme të Kuvendit, në fund të çdo sesioni parlamentar përgatisin një raport për shkallën e zbatueshmërisë të kodit”.

Vasilika Hysi - Kjo është çështja.

Fatmir Xhafaj - Ata janë komision përgjegjës dhe e shikojnë në mënyrë më të kompletuar.

Vasilika Hysi - Jo, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj - Po çfarë?

Vasilika Hysi - Komisioni ynë dhe çdo komision i përhershëm e ka për detyrë, në bazë të Rregullores së Kuvendit, të bëjë raportin.

Fatmir Xhafaj - Po e ke këtu.

Vasilika Hysi - A jemi ne në gjendje të bëjmë raporte, studime, kërkime të tilla që të raportojmë të Komisioni i Integrimit European?

Në bazë të pikës 2 të nenit 20: “Komisionet e përhershme të Kuvendit në fund të çdo sezoni përgatisin raport për shkallën e zbatueshmërisë të kuadrit normativ”. Kjo do të thotë që ne duhet t’i marrim të gjitha aktet normative në një fushë të caktuar që janë në kompetencë, për shembull, të Komisionit të Ligjeve, të bëjmë përputhshmërinë dhe të themi që ku zbatohet dhe ky nuk zbatohet. A mund ta bëjmë ne me kapacitetet që kemi, me stafin dhe me kohën? Ky është shqetësimi që kam ngritur në relacion.

Majlinda Bregu – Atëherë, zonja Hysi, në rast se do të shohim çdo gjë me syrin e Rregullores se çfarë parashikon, ky proces shkon një hap përpara për shkak të detyrimeve që do të kemi, pra detyrimet që procesi do të sjellë para nesh në momentin kur do të fillojë hapja e negociatave. Kuvendi duhet ta ketë gati për ta dorëzuar bazën ligjore të miratuar bashkë me komentet përkatëse. Pra, është një vandak tjetër me letra, që duhet të jetë gati. Është më mirë që të fillojmë dhe t’i marrim përgjegjësitë që sot.

Në rast se kjo gjë konfliktuon me stafin e komisionit tuaj dhe të komisionit tonë, as ne nuk kemi staf, atëherë hajde t'i kërkojmë Kuvendit, Drejtorisë së Përafrimit të Legjislacionit, apo kujtdo të ngrejë një strukturë mbështetëse. Gjithsesi ky është një detyrim, të cilin nuk mund ta shmangim. Jemi të detyruar që deri në vitin 2019 të mbyllim të gjithë raportimin për MSA-në nen për nen. Kjo do të thotë që është mirë të nisim punën, sepse nuk shpëtojmë dot. Prandaj është vënë kjo pikë në këtë ligj.

Fatmir Xhafaj – E vetmja gjë është raporti për shkallën e zbatueshmërisë së kuadrit, sepse shkalla e përafrimit është një çështje tjetër. A i kemi kapacitetet për ta bërë? Unë nuk jam ekspert i kësaj fushe dhe hezitohet, por ju që e njihni, sepse të dy jeni edhe politikanë, edhe njohës të fushës, për të mos thënë ekspertë të saj, në këndvështrimin tuaj, a i ka kapacitetet një komision i përhershëm të bëjë një analizë të tillë për zbatueshmërinë e të gjithë aktit normativ në praktikë?

Majlinda Bregu – Sot kjo nuk arrihet.

Fatmir Xhafaj – Si ta formulojmë, që të jetë sa më qartë, sepse do të na jepni një gjë që nuk e mbajnë shpatullat tona?

Majlinda Bregu – Unë jam e qartë se ne nuk arrijmë dot që të bëjmë edhe monitorimin e zbatueshmërisë së legjislacionit. Nuk mund ta parashikojmë ligjin ngushtësisht pse nuk e bëjmë, sepse do të detyrohemi të bëjmë.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka problem.

Majlinda Bregu – Le të mendojmë një mekanizëm tjetër, ku t'u kërkojmë ministrive të na raportojnë. Pra, të na raportojnë ato, sepse i kanë agjencitë e zbatimit të ligjit.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, a mos do një riformulim më të saktë?

Majlinda Bregu – Tani që e thatë ju, po e mendoj edhe unë. Pra, mund t'u kërkojmë ministrive që, bashkë me kuadrin legjislativ për t'u miratuar, që do të sjellin në fillim të vitit, të bëjnë edhe një raport për zbatueshmërinë e vitit paraardhës dhe komisioni të bëjë vlerësimin sa përputhet.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pra, të jetë një bashkëpunim ndërmjet legjislativit, komisionit përgjegjës dhe ministrive të linjës.

Majlinda Bregu – Ndoshta mund t'ia japim kompetencë raportin e parë këshillit dhe më pas t'ua përcjellim juve për zbërthim, për të shmangur 100 hallka.

Fatmir Xhafaj – “Bashkëpunimi me shoqërinë civile”?

Vasilika Hysi – Unë kam një shqetësim për pikën 2, që sugjeroj të riformulohet, sepse i jep të drejtë Komisionit për Integrimin Europian që të organizojë tryeza të hapura publike me shoqërinë civile për zhvillimet social-ekonomike në nivel kombëtar. Është shumë e gjerë. Në kuadër të miratimit dhe të zbatimit të politikave Komisioni i Integritetit Europian monitoron zbatimin e detyrave që kemi, porgresraportin e BE-së në kuadër të negociatave, por me një formulim kaq të hapur të lë mundësinë të merresh me çfarëdolloj gjëje.

Fatmir Xhafaj – Pika 3 e përfshin pikën 2. Pra, ta heqim pikën 2 dhe të lëmë vetëm pikën 3.

Atëherë, hiqet pika 2 dhe pika 3 bëhet 2, ndërsa pika 4 bëhet 3.

Neni 22? Dakord.

Neni 23? Dakord.

Neni 24? Dakord.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Dakord.

Zonja Bregu, faleminderit që ishit e pranishme!

Majlinda Bregu – Faleminderit juve!

Fatmir Xhafaj – Falënderoj kolegët, zotin Balla, që nuk është i pranishëm, dhe zonjën Mehmeti, që është nismëtare!

Uroj që të mos e politizoni më tej këtë projekt!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruar nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksioneve të BERZH-it, për planin e qëndrueshëm të transportit në Shqipëri”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Tom Doshi, Petrit Vasili, Silva Caka, Eduart Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri dhe Mhill Fufi.

Mungojnë:

Të ftuar:

Elona Mestrovica – Sektori i Huamarrjes në Ministrinë e Financave

Argita Totozani – drejtore në Drejtorinë e Integritimit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me propozimin e projektligjit: “Për ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruara nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksioneve të BERZH-it, për planin e qëndrueshëm të transportit në Shqipëri”

Nga Ministria e Transportit kërkoj një prezantim të nivelit që përfaqësoni dhe të projektit. Ju lutem, ju jeni drejtoresha më duket!

Ju lutem, prezantohuni!

Argita Totozani – Unë jam Argita Totozani, drejtoresha e Përgjithshme e Integritetit, që përfshin edhe projektet e huaja.

Granti i BERZH-it është negociuar që dy vjet përpara dhe është në vlerën 289,383 euro, por për faktin se procedura nuk është bërë siç duhet, marrëveshja u firmos dy vjetët e fundit dhe është një grant që adreson planin e qëndrueshëm të transportit.

Qëllimi i grantit, i marrëveshjes dhe i firmës, e cila do të zbatojë këtë marrëveshje është përcaktimi i një plani, prodhimi i një dokumenti i cili do të përcaktojë harxhimin e energjisë në të gjitha fushat e transportit dhe infrastrukturës në përputhje me standardet europiane të BE-së që janë përcaktuar.

Aktualisht kompania konsulente, që ka marrë kontratën do të bëjë një studim të niveleve të harxhimit të energjisë nga transporti në Shqipëri. Kjo gjë duhet të jetë në bazë të specifikimeve të BE-së në nivele të ulëta për faktin edhe të konsumit të energjisë, por edhe të mbetjeve të transportit rrugor, hekurudhor, detar dhe ajror.

Aktualisht është 45% e shpenzimit të energjisë nga sektorët e transportit dhe ky plan ka për qëllim uljen e këtij niveli të harxhimit të energjisë nga sektorët transportit.

Fatmir Xhafaj – Projekti është përpara. Relatori, zoti Peza a keni ndonjë koment shtesë?

Dashamir Peza – Jo nuk kam. Por kam vetëm një pyetje, zoti kryetar. Nëse ky projektligj apo ky ratifikim, që bëjmë sot, ngarkon detyrime financiare për Republikën e Shqipërisë, apo jo?

Argita Totozani – Po ngarkon se me detyrim është që qeveria shqiptare paguan koston lokale dhe TVSH-në e projektit, e faturave që ata lëshojnë. Por është minimale dhe do të

parashikohen në 6-mujorin e dytë të këtij viti, mund të më mbështesë edhe kolegja nga Ministria e Financave, është 20% e vlerës të projektit që është 289,383 euro.

Fatmir Xhafaj – Domethënë, ka detyrime financiare?

Argita Totozani – Po aktualisht ka TVSH-në dhe koston lokale.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja nga Ministria e Financave!

Elona Mestrovica – Jam Elona Mestrovica nga Sektori i Huamarrjes.

Këto në fakt nuk janë efekte financiare, sepse nuk regjistrohen, as në të ardhura, as në shpenzime, por janë thjesht parashikime të kostove që mund të lindin, sepse për shërbimet e konsulencës nuk kemi kosto të tilla.

Fatmir Xhafaj – Atëherë lind pyetja, pse e sillni në Kuvend?

Elona Mestrovica – Nuk e sjellim ne, por Ministria e Punëve të Jashtme.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Zoti Peza, a keni gjë tjetër për të shtuar?

Dashamir Peza – Unë do të doja ta kisha të qartë këtë pozicion, lidhur me këtë çështje. A ngarkohet Republika e Shqipërisë me detyrime financiare apo jo? Unë do të doja një përgjigje përfundimtare.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! A ka njeri tjetër për të shtuar ndonjë gjë lidhur me këtë projekt? Nuk ka. Pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Dakord.

Neni 1. Dakord.

Neni 2. Dakord.

Në tërësi. Dakord

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 02.03.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjeve të grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant, të siguruar nga BERZHI-i, nga burimet e veta, nën fondin e veçantë të aksioneve, për strategjinë e taksimit rrugor në Shqipëri”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Bashkim Fino, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Arben Ristani, Eduart Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Tom Doshi, Petrit Vasili, Mhill Fufi.

Të ftuar:

Elona Mestrovica – Sektori i Huamarrjes në Ministrinë e Financave

Argita Totozani – drejtore në Drejtorinë e Integritetit në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës

Fatmir Xhafaj - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjeve të grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si administrator i fondeve grant, të siguruara nga BERZHI-i, nga burimet e veta, nën fondin e veçantë të aksioneve, për strategjinë e taksimit rrugor në Shqipëri”

Përsëri besoj një ekspozë nga zonja drejtoreshë!

Argita Totozani – Faleminderit!

Atëherë siç e dimë, për momentin nuk ka një strategji të taksimit rrugorë. Deri tani asnjë nga inventari i rrugëve që kemi trashëguar në Shqipëri nuk taksohet dhe si rrjedhim Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka vendosur të mbështesë reformën në sektorin rrugor. Të ardhurat për mirëmbajtjen e rrugëve e kanë burimin nga fondi i buxhetit të shtetit dhe në kushtet e përballjes në kufizime buxhetore lind nevoja për të konsideruar mundësinë e futjes së sistemit të taksave rrugore, me qëllim unifikimin e një strategjie për nivelin e rrugëve, duke paraqitur rëndësinë dhe prioritetin e tyre. Duhet të përpilohet një strategji, e cila t’i përfshijë të gjitha kategoritë e rrugëve, sipas rëndësisë së prioritetit, edhe taksimi do të bëhet i tillë.

Në bashkëpunim edhe me IFC-në, kompania që ka fituar konsulencën do të bëjë edhe hartimin e kësaj strategjie, që do t’i lejë vendit për të përcaktuar nivelin e taksave për çdo rrugë parësore apo dytësore sipas strategjisë që do të përcaktohet. Vlera është 149 mijë e 117 euro, projekti ende nuk ka filluar të zbatohet, nuk e kemi firmosur ende kontratën me konsulentin, të shpresojmë ta bëjmë sa më shpejtë.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Relatori?

Dashamir Peza - Nuk kam asgjë, jam dakord.

Fatmir Xhafaj - Ka pyetje? Urdhëroni, zoti Bylykbashi!

Oerd Bylykbashi - Do të doja të dija nga specialistët se kur ka filluar negociimi për këtë grant? Unë shikoj datën e miratimit kur është nënshkruar marrëveshja, por do të doja të dija se kur ka filluar negociimi.

Argita Totozani - Dakord, faleminderit!

Negociimi duhet të ketë filluar 2 vjet më parë, unë nuk kam qenë në këtë pozicion që t’ju them, por e di që marrëveshjet janë negociuar në vitin 2013 ose në vitin 2014. Megjithatë nuk

ishite legjitimuar me një marrëveshje, është negociuar kontrata e konsulencës, është bërë procesi i përzgjedhjes së konsulentit, por pa u bërë një marrëveshje qeveritare. Meqenëse BERZH-i e kishte, në njëfarë mënyre jo ndjekur, shkelur procedurën e qeverisë shqiptare, u detyruam që marrëveshja të prodhohej tani, për të legjitimuar kontratën e konsulencës. Meqenëse ishte grant, BERZH-i dhe Banka Europiane mendoi që ky grant do t'i jepej vetëm me kontratën e konsulencës. Marrëveshja pas 2 vjetësh u bë për procedurë dhe për legjitimitet.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Faleminderit!

Në fakt, që të legalizosh një procedurë jo të rregullt nuk është normale, as që ne të bëjmë një marrëveshje tani për diçka që është bërë gabim më përpara. Megjithatë, kjo është gjë tjetër.

Pra, ka filluar në vitin 2014 negociimi dhe procesi po mbyllet eventualisht me këtë marrëveshje. Ju thatë që nuk ka një strategji të taksimit rrugor, pra do të bëhet një strategji edhe me ndihmën e këtij granti.

Deri më sot nuk kemi pasur taksa rrugore. Nga kjo që ju parashikoni, strategjia do të vendosë një numër të ri taksash. Keni një vlerësim se sa do të jetë ky volum taksash të reja që do t'u vendoset shqiptarëve në këtë ditë të vështirë ekonomike? A keni ndonjë ide?

Argita Totozani - Faleminderit për pyetjen!

Si volum taksash nuk e kemi idenë. Kemi një inventar rrugësh, po themi prej 800 kilometrash dhe ky inventar rrugësh është i trashëguar, nuk është i gjithë për t'u taksuar. Do të shikohet fluksi, do të bëhet matje nga pasagjeri, fluksi i pasagjerëve që kalojnë në çdo rrugë dhe prioriteti, të gjitha standardet ekonomike, politike dhe prioritare të çdo rruge, në bazë të tyre edhe strategjia do të përcaktojë se cila nga këto rrugë do të derivojë taksë, cila ka prioritet, cila ka fluksin më të madh të kalimit të pasagjerëve dhe cila jo. Strategjia do të parashikojë rëndësinë apo jo të rrugëve në rrjetin rrugor që ne kemi trashëguar? Në kuptimin e vlerës totale, jo. Absolutisht ne nuk kemi ende të dhëna të sakta për këtë.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi - Faleminderit!

Deri më sot ne kemi arritur ta menaxhojmë sistemin e rrugëve në këtë formë: të bëjmë investime të reja; rrugë të reja; të rrisim sigurinë në to dhe t'i mirëmbajmë me këto standarde që kemi deri më sot.

Kur bëhet një strategji për taksimin, nuk bëhet për pak taksë, asnjë qeveri nuk e merr mundimin politik dhe koston që ta bëjë për pak, bëhet për një vlerë të caktuar që të kontribuojë në volumin edhe të investimit që bëhet në mirëmbajtjen e rrugëve apo investimet e reja. Unë gjykoj që volumi i taksës dhe i barrës së re fiskale që do të jetë mbi shqiptarët nuk do të jetë i vogël, do të jetë i konsiderueshëm. Se sa, do ta shikojmë.

A mundet që ne ta shtyjmë në kohë? Është kaq urgjente që duhet ta bëjmë tani apo ta shtyjmë në kohë, në mënyrë që shqiptarët të mos e vuajnë edhe këtë taksë tjetër? A mund të fillojë më vonë? Si është parashikuar?

Fatmir Xhafaj - Zoti Peza, urdhëroni!

Dashamir Peza - Zoti kryetar, ne jemi duke diskutuar financimin nga BERZH-i të një projekti të BERZHI-it.

Fatmir Xhafaj - Të një projekti të BERZHI-it?

Dashamir Peza - Po, për një projekt të BERZH-it. Nuk jemi duke folur këtu për strategjinë, duhet të ngelemi te pyetja.

Fatmir Xhafaj - Zoti Bykykbashi, urdhëroni!

Oerd Bylykbashi - Nëse nuk bie ndesh me këtë që tha zoti Peza, unë kam edhe një pyetje të fundit: taksimi, besoj dhe dy elemente janë të qarta për ata që hyjnë për një strategji, ka problematikën, dyshojnë edhe zgjidhjen. Parashikoni të bëhet përsëri me koncesion, t'i jepet koncesion dikujt apo do të ketë një formë standarde shtetërore të mbledhjes së taksës? Kjo nuk ka të bëjë me volumin, në qoftë se zoti Peza nuk është dakord, e tërheq edhe këtë pyetje.

Fatmir Xhafaj - Jo, jo. Problemi është se a është ajo në gjendje për një projekt që do të bëhet nesër?

Zonja drejtoreshë, urdhëroni!

Argita Totozani - Për sa i përket strategjisë së përgjithshme, kjo është politikë dhe nuk jam në pozicion për të kthyer përgjigje sot se si do të jetë. Siç jeni në dijeni, buxheti për mirëmbajtjen e rrugëve dhe për investime të reja është zero. Të gjithë e dimë këtë dhe jemi koshentë. Strategjia do ta përcaktojë. Edhe marrja e taksave ka një kuptim për sa i përket mirëmbajtjes, mirëmbajtja e rrugëve është e nevojshme, se do të humbim edhe atë inventar që kemi.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Dakord, faleminderit!

Zonjë e Ministrisë së Financave, kam unë një pyetje.

Ky është një projekt i dhënë nga BERZH-i për politikën e tij apo një projekt i kërkuar nga Shqipëria?

Dhe e dyta, sot në këtë vend a paguhet taksa kombëtare për rrugët, apo jo? Në listën e taksave kombëtare, çdonjëri nga ne paguan diçka për mirëmbajtjen e rrugëve e të tjera, apo jo?

Elona Mestrovica - Natyrisht që BERZH-i do të ketë qenë në kontakt me ministrinë zbatuese për të evidentuar nevojat e investimeve, kështu që nuk kemi as legjitimitet të çështja që u ngrit më parë, të një procedure të kryer në mënyrë jo të rregullt. Është propozuar nga BERZH-i, në konsultim me Ministrinë e Transportit, që të financohet ky grant.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky propozim na ka ardhur në Ministrinë e Financave në vitin 2014. Menjëherë është marrë dakordësia e ministrisë së linjës, janë ndjekur procedurat e negocimit, të miratimit në parim të nënshkrimit dhe sot jemi në procedurën e ratifikimit. Pra, këtu nuk ka ndonjë legjitimitet. Kontratat do të vijnë natyrisht pasi të ratifikohet dhe të hyjë në fuqi kjo marrëveshje dhe të gjitha çështjet e adresuara deri tani do të marrin zgjidhje kur të jetë produkti final i saj, që do të jetë strategjia.

Lidhur me çështjen e taksave, unë në këtë moment nuk mund të jap një përgjigje që të jetë ezauruese.

Vasilika Hysi - Ju kërkoj ndjesë!

Po shikoj marrëveshjen e grantit dhe në pjesën e hyrjes thuhet “duke pasur parasysh”, thuhet se shifra 289 mijë e 383 euro është shuma e grantit dhe më pas te neni 2/1 thuhet se do të lëvrohet 149 mijë e 117 euro. Pra, kjo është shuma maksimale e grantit? Sepse ka dy shuma këtu. Edhe shuma maksimale e kontratës suaj është 149 mijë e 117 euro, por granti që banka bie dakord dhe vendos në pozicion të marrësit është 149 mijë e 117 euro.

Elona Mestrovica - Duhet të ketë ndonjë gabim midis dy marrëveshjeve. Marrëveshja e kaluar, e sapomiratur e planit të transportit të qëndrueshëm e ka shumën 289 mijë e 383 euro, ndërsa marrëveshja e taksimit rrugor ka vlerën e 149 mijë e 117 euro. Mos është lapsus i relacionit shoqërues?

Elona Mestrovica - Ne si Ministri e Financave, në produktin që kemi dorëzuar, në kopjen në anglisht është e saktë, 149 mijë e 117 euro. Ai duhet të jetë një problem i pjesës së certifikimit, prandaj po e diskutoj me kolegët.

Fatmir Xhafaj – Dakord, ka gjë tjetër për këtë gjë?

Ta miratojmë në parim, por nuk do ta nënshkruajmë për ta kaluar në seancë nëse nuk e sjellin të saktësuar projektin, dakord? Që të mos vijmë herë tjetër me duar në xhepa. Dakord, zoti Peza?

Dashamir Peza - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Pyetje, nuk ka. Diskutime, nuk ka.

Kush është dakord në parim? Dakord.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet me rezervën që ju thatë. Të dyja do të kalojnë në seancë nëse nesër Ministria e Financave dhe Ministria e Transportit sjellin saktësimin e marrëveshjeve në origjinal.

Faleminderit!

MBLEDHJA MBYLLET